

EKSTRAKT

nga Politika e Perputhshmerise e OTP Bank Albania sha

I. DISPOZITAT HYRESE

OTP Bank Albania sha ("Banka" ose "OBA") siguron perputhshmeri me ligjet dhe rregulloret e brendshme, si dhe identifikimin dhe menaxhimin e riskut te perputhshmerise ne perputhje me kerkesat rregullatore lokale dhe udhezimet e Grupit.

Risku I perputhshmerise eshte risku potencial ligjor, risku nga autoritetet ose sanksione te tjera zyrtare, apo humbjeve te konsiderueshme financiare, apo demit reputacional per shkak te mos respektimit te legjislacionit ose standarteve te tjera jo-legjislative dhe rregullave te brendshme te zbatueshme per organizaten dhe qe kane te bejne me aktivitetin e saj te sherbimit.

Dokumentet e meposhtme te publikuara ne faqen zyrtare te bankes perbejne anekset e Politikes se Perputhshmerise :

- Politika per mbrojtjen e te dhenave ;
- Politika kunder korrupsionit ;
- Politika e mediave sociale ;
- Politika e sanksioneve ;
- Politika e Financimit te Industrise se Mbrojtjes.

II. DISPOZITATE PERGJITHSHME

II.1. Qellimi I rregullores

Aktiviteti I funksionit te Perputhshmerise mbulon gjithe **OTP Bank Albania sha** (ketu e tutje referuar si Banka), duke perfshire gjithe aktivitetet dhe njesite e saj organizative. Palet e nenkontraktuar qe kryejne aktivite nga burime te jashtme (outsourced) ose qe mund te angazhohen si ekspert apo keshillues, pavaresisht nese eshte individ fizik apo ligjor, duhet te zbatoj kerkesat dhe standartet e perputhshmerise.

II.2. Pozicioni I funksionit te Perputhshmerise ne sistemin e linjes se brendshme te kontrollit

Ne perputhje me kerkesat ligjore lokale dhe udhezimeve te Grupit, Banka duhet te permbushi vendosjen e linjave te brendshme te mbrojtjes dhe sigurise per te promovuar sa vijon :

- a) aktivitet te kujdeshem ne perputhje me ligjin dhe rregulloret e brendshme ;
- b) mbrojtja e pasurive te ofruesit te sherbimit, si dhe interesat dhe qellimet sociale te pronareve perfitues dhe klienteve ne lidhje me ofruesin e sherbimit ;
- c) aktivitet i qendrueshem dhe fitimprures te ofruesit te sherbimit ;

Linjat e brendshme te mbrojtjes ne Banke perfshijne funksionet e pergjegjshme te qeverisjes dhe funksionet e kontrollit te brendshem.

Funksionet e kontrollit te brendshem perfshijne funksionin e kontrollit te riskut, funksionin e perputhshmerise dhe funksionin e kontrollit te brendshem.

II.3. 2.3 Principet qe udheheqin funksionin e perputhshmerise

Perputhshmeria funksionon ne menyre te tille qe te krijoje nje kulture korporative te ligjshme dhe etike qe siguron funksionimin e kujdesshem dhe etik te **Bankes** ne plan afatgjate.

Ne rrjedhen e funksionimit te perputhshmerise, Banka zbaton parimet e meposhtme :

- Pavaresi
- Integritet
- Operacione panderhyrje
- Qasje pro-aktive dhe parandaluese
- Qasje e orientuar drejt riskut
- Proporcionalitet
- Perkujdes professional dhe kompetenca te nje niveli te larte
- Mbulim te plote
- Efikasitetin, racionalizim te kostove te perputhshmerise

III. DISPOZITA SPECIFIKE

III.1. Aktivitetet kryesore te perputhshmerise

III.1.1. Perpunimi dhe mbrojtja e te dhenave personale - GDPR

OTP Bank Plc eshte e angazhuar ne mbrojtjen e duhur te te dhenave personale te perpunuara nga ajo, ne perputhje me dispozitat e Rregullores se Pergjithshme te mbrojtjes se te Dhenave dhe ligjeve dhe rregulloreve perkatese te aplikueshme. Si pjese te kesaj, OTP Bank Plc. zhvillon, zbaton dhe ve ne funksion nje sistem per rregullimin, funksionimin dhe kontrollin e duhur per mbrojtjen e duhur te te dhenave personale duke permbushur kriteret e specifikuara ne legjislacionin ne fuqi dhe duke mbrojtur interesat kryesore te biznesit te Bankes.

III.1.2. Konflikti I Interesit, Etika ne sjelje

Eshte ne interes te biznesit te Bankes dhe nje detyrim ligjor per te siguruar se interesat personale te punonjesve te saj dhe te anetareve te Keshillit Drejtues nuk jane ne konflikt me interesat e biznesit dhe angazhimin e Bankes dhe te klienteve te saj, dhe se Banka identifikon, parandalon dhe menaxhon konfliktin e interesit ne lidhje me aktivitetet e saj te ndryshme dhe rregulon dhe vlereson nga ana e perputhshmerise furnitoret/partneret e biznesit (filtrim te furnitoreve).

Me qellim mbrojtjen e vlerave te saj dhe te klienteve, Banka formulon kerkesa ne lidhje me operacionet etike te biznesit

Banka zhvillon dhe zbaton rregulla mbi konfliktin e interesit dhe etiken, dhe kërkon që të gjithë manaxheret dhe njesite e kontrollit të ndermarrin veprime të prera kundër çdo lloj shkelje të këtyre rregullave. Banka ka politiken e sinjalizimit dhe kontaktet perkatese për raportimin e shkeljeve të standarteve etike dhe të dispozitave ligjore mbi rregullat e përputhshmerise. Qendrimi i Bankes kundrejt politikave të anti-korrupsionit është i shprehur qartë tek Kodi i Etikes të publikuar në faqen zyrtare të Bankes.

Banka harton Politiken e Konfliktit të Interesave për të percaktuar rrethanat që lidhen me veprimtarinë e saj të shërbimit të investimeve, shërbimet ndihmese dhe shërbimet financiare perkatese, të cilat çojnë ose mund të çojnë në një konflikt të mundshëm interesi që mund të shkaktojë pasoja të padëshirueshme për partnerin e biznesit.

Politika gjithashtu percakton në mënyrë të detajuar rregullat procedurale dhe masat që lejojnë parandalimin, identifikimin dhe menaxhimin e situatave të konfliktit të interesit që janë potencialisht paragjyqese për partnerin e biznesit.

III.1.3. Përputhshmeria me kufizimet në rrjedhjen e informacionit midis aktivitetëve financiarë dhe shërbimeve të investimeve

Banka zbaton një mekanizëm të brendshëm organizativ, operacional dhe procedural për të siguruar se të dhënat dhe rrjedhja e informacionit ndërmjet njesive organizative përgjegjëse për shërbimet financiare, shërbimet ndihmese financiare dhe shërbimet e investimit janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe rekomandimet.

Njesite organizative në **Banke** mund të zbulojnë ndërmjet tyre informacione konfidenciale bankare dhe të titujve vetëm sipas parashikimeve në rregulloret e brendshme të zbatueshme.

Për më tepër, **Banka** siguron se çdo person mund të ketë akses në sekretet bankare dhe atë të titujve vetëm në bazat e "need-to-know".

III.1.4. Parandalimi i abuzimit të tregut (veprimet e brendshme, manipulimi i padrejte i praktikave)

Në jemi pjesë e Grupit OTP dhe kompania mëmë OTP Bank Plc., si një emetues i shquar në Bursën e Budapestit, pra në cilësinë e tij si emetues, ofrues i shërbimit të investimeve dhe institucion krediti, është e perkushtuar në ruajtjen e transparencës dhe efikasitetit në tregjet e kapitalit, në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi.

Në kuader të legjislacionit dhe rregulloreve të brendshme në fuqi, Banka ndalon tregtine e brendshme dhe përpjekje të tregtimit të brendshëm përse i perket instrumentave financiarë të kompanive të cilat leshohen në oferta publike dhe në lidhje me të cilat personi i brendshëm ka marrë informacion. Shkëmbimi i këtij informacioni gjithashtu është i ndaluar.

Banka kundershton gjithë format e tregtimit të brendshëm, duke kryer analiza dhe vlerësime të incidenteve dhe duke ndermarre masa për parandalimin e incidenteve të tilla, ose adresimin e incidenteve që kanë ndodhur.

Banka kundershton gjithë format e sjelljes që përfshijn një manipulim potencial të tregut, ose është në kundërshtim me parimet e përgjithshme profesionale të pranuar, ose zbulon informacion të pabazuar, të gabuar ose potencialisht të rreme dhe jep sinjale të këtij karakteri në lidhje me çmimin e një instrumenti specifik financiar, ose artificialisht e mban çmimin e një instrumenti në një nivel jo normal.

III.1.5. Trajtim i drejtë i klienteve, mbrojtja e konsumatorit

Banka është e angazhuar në zbatimin e interesave të konsumatorëve. Në këto kuader, ai ndjek parimet për mbrojtjen e konsumatorit që janë në përputhje me qasjen e tyre dhe merr në konsideratë ndryshimet në zakonet dhe interesat e konsumatorit.

III.1.6. Sigurimi i përputhshmërisë me kërkesat që kanë të bëjnë me aktivitetet e shërbimit të investimit të ofruara nga Banka

Sigurimi i shërbimeve të investimit:

- a. Banka monitoron vazhdimisht dhe vlerëson rregullisht përshtatshmërinë dhe efektivitetin e masave dhe procedurave që lidhen me shërbimet e investimeve, si dhe masat që synojnë adresimin e mangësive të përputhshmërisë.
- b. Banka merr të gjitha masat e kërkuara për të siguruar që urdherat të kryhen në interesin më të mirë të klienteve, dhe se ajo ushtron kujdes dhe maturi maksimale në menaxhimin e instrumenteve dhe investimeve financiare të klienteve.

Transaksionet personale:

- a. Banka ka ndermarre një angazhim për të mbrojtur interesat e pjesëmarrësve të tregut të kapitalit, investitorëve dhe klienteve, për të ruajtur konkurrencën e ndershme dhe për të parandaluar abuzimin e tregut dhe konfliktin e interesave. Për këto qëllime, ai rregullon përfundimin, njoftimin dhe regjistrimin e çdo transaksioni nga personat në fjalë që janë të lidhur me aktivitetet e shërbimeve të investimit ose ofrimin e shërbimeve ndihmëse të investimeve.
- b. Banka është e ndërgjegjshme për zhvillimin e një mjedisi rregullator të brendshëm që është i përshtatshëm për të parandaluar personat e përfshirë në aktivitete që çojnë në konflikte të mundshme të interesit të përfundojnë transaksione që janë të ndaluara me ligj ose përfshijn përdorimin e paligjshëm të informacionit konfidencial ose mund të rezultojnë në konflikte të interesit, duke pasur akses në informacione të brendshme si rezultat i aktivitetit të tyre ose në

informacion konfidencial si rezultat i marredhenies se tyre me klientet.

III.1.7. Qeverisja e Korporates

Nen frymen e pergjegjeshme te qeverisjes se korporates, Banka ka udhezime ne fuqi qe sigurojne qe operacionet e saj perputhen me rregullat lokale dhe udhezimet e Grupit mbi qeverisjen e korporates, dhe qe publikimi i informacionit mbi qeverisjen dhe operacionet e tij e ben ate nje kompani transparente dhe te verifikueshme.

Ne praktiket e saj te biznesit, **Banka** merr parasysh interesat e Grupit, aksionareve te saj, klienteve dhe partnerit te biznesit.

Ne zhvillimin e produkteve te saj dhe dhenien e aksesit ne sherbimet e saj, Banka perputhet me parimet dhe standardet e etikes dhe mbrojtjen e konsumatorit me ane te te cilave sigurohet qe sherbimet e ofruara jane moderne, me cilesi te larte dhe te drejta duke plotesuar nevojat e klienteve.

Ne perputhje me kriteret e qendrueshmerise (ESG), Banka vlereson veprimtarine e saj nga aspekti i ndikimit te veprimtarise ne mjedis (E), drejtesise sociale (S), dhe ceshtjeve perkatese te qeverisjes korporative (G) dhe siguron perpuethshmeri me kerkesat perkatese legjislative.

III.1.8. Perputhshmeria me marreveshjet nderkombetare te taksave

Banka ka interes themelor dhe detyrim ligjor per te qene ne perputhje me kerkesat e percaktuara per identifikimin dhe raportimin e klienteve sipas standarteve nderkombetare te taksave, FATCA per SH.B.A dhe CRS per OECD, bazuar ne detyrimet ligjore per raportim qe Shqiperia duhet te zbatoje.

III.1.9. Perputhshmeria me kerkesat e sanksioneve nderkombetare dhe mbrojtja e reputacionit te Grupit Bankar

Banka ka interes themeltar dhe nje detyrim ligjor per te siguruar respektimin e plote te kerkesave per identifikimin dhe raportimin e klientit, sipas kerkesave te percaktuara ne marreveshjet nderkombetare te taksave, siç jane FATCA per SH.B.A. dhe CRS per OECD dhe Bashkimin Evropian bazuar ne detyrimet e Shqiperise dhe ligjeve te implementuara perkatesisht.

Ne faqen e saj zyrtare, Banka publikon Politiken e Sanksioneve ne Nivel Grupi mbi parimet e pergjithshme te zbatimit te sanksioneve financiare nderkombetare dhe Politiken ne nivel Grupi per Financimin e Industrise se Mbrojtjes.

Ne interes te ruajtjes se pozicionit te saj financiar ne treg dhe reputacionit te mire, Banka mbeshtet bashkepunimin nderkombetar dhe eshte ne perputhje me rregullat ligjore, harton dhe pershtat rregulloret si dhe proceset dhe praktiket e perdritshme ne menyre qe te sigurohet

perputhshmeria e duhur me detyrimet qe lidhen me sanksionet dhe per te mbrojtur reputacionin e Grupit Bankar.

Në ndjekjen e qëllimeve të politikës së saj të biznesit, Banka përpiqet të shmangë transaksionet sensitive që mund të dëmtojnë reputacionin dhe marrëdhëniet e biznesit të Bankës dhe Grupit Bankar dhe në përputhje me rrethanat, ajo inspekton - veçanërisht por pa u kufizuar në - transaksionet aktive në lidhje me mallrat ushtarake , produkte dhe teknologji me përdorim të dyfishtë, nxjerrja e naftës së papërpunuar, energjia bërthamore dhe kriptomonedhat.

III.2. Parimet dhe kerkesat e pergjithshme

III.2.1. Pergjegjësia per Perputhshmerine

Siç percaktohet ne kerkesat ligjore ne fuqi dhe ne dispozitat dhe rregulloret e brendshme, ekzekutivi, menaxheret, punonjesit e Bankes kane pergjegjesi te pergjithshme per zbatimin e kerkesave dhe rregullave te perputhshmerise. Te gjithe punonjesit e kane per detyre qe te zbatojne kerkesat e perputhshmerise, te raportojne cdo rrethane qe rrezikon zbatimin dhe te marre pjese ne eliminimin e kesaj rrethane.

III.2.2. Parimet per perdorimin e Keshilluesve dhe Eksperteve te jashtem

Per te siguruar zbatueshmerine e standarteve te parashikuara ne kete Politike, te gjithe personat qe veprojne si eksperte apo keshillues te jashtem ne emer te Bankes kerkohet te deklarojne se e kane lexuar dhe kuptuar ekstraktin nga Politika e Perputhshmerise dhe pranojne qe do te zbatojne kerkesat e saj.